



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Drzavna Agencija za Zastitu Licnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr. prot 24/2012
Datë: 01.10.2012

Në mbështetje të nenit 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5.) të Ligjit Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 70/31 maj 2010) Mbikëqyrësi Shtetëror merr këtë:

V E N D I M

1. Këshillohet Kuvendi i Republikës së Kosovës që të marrë vendim për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë.
2. Të vendosë njoftimin për instalimin e sistemit të vëzhgimit.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës, në afat prej 15 ditësh të njoftojë Agjencinë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Në bazë të nenit 46, nenit 47 dhe nenit 48 (paragrafi 1.1.4.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstinë metejmë LMDHP), më datë 26.07.2012, Agjencia ka realizuar kontrole sipas detyrës zyrtare në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe ka konstatuar se vendosja e sistemit të vëzhgimit me kamerë nuk përmbushë rregullativën ligjore.

Pas kontrollit është përpiluar procesverbali me nr.04/2012, i cili është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës dhe të njëjtit i është dorëzuar një kopje.

Në bazë të kontrollit të bërë, në procesverbal është konstatuar kjo gjendje:

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka të instaluar sistemin e vëzhgimit me kamerë, por nuk ka vendim të shkruar për instalimin e sistemit të vëzhgimit. Në nenin 62 (paragrafi

2 dhe 3) të LMDHP, thuhet që vendimet e nevojshme merren nga nëpunësi kompetent, drejtori ose ndonjë person tjetër i autorizuar nga sektori publik ose privat. Vendimi duhet të përmbajë arsyet për vendosjen e sistemeve të vëzhgimit me kamerë.

Sistemi i vëzhgimit me kamerë është i vendosur në hapësirën e brendshme të ndërtesës, ku kamerat monitorojnë lëvizjet e të punësuarve dhe personave të tjerë që lëvizin në atë pjesë. Në nenin 62 (paragrafi 1) thuhet se personat në sektorin publik dhe privat mund të instalojnë sistemet e vëzhgimit me kamerë për vëzhgimin e ndërtesave të tyre nëse konsiderohet e nevojshme për sigurinë e njerëzve dhe sigurimin e pasurisë. Vëzhgimi me kamerë në veçanti mund të jetë i nevojshëm për të vëzhguar hyrjet e ndërtesave, ose ku për shkak të natyrës së punës së tyre ekziston kërcënim potencial ndaj të punësuarve.

Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka të vendosur njoftimin për instalimin e sistemet e vëzhgimit me kamerë. Në nenin 61 (paragrafi 2) të LMDHP thuhet se personat në sektorin publik ose privat që kanë për qëllim të instalojnë sistemet e vëzhgimit me kamerë duhet të vendosin njoftimin për këtë. Njoftimi i tillë duhet të jetë i dukshëm dhe të bëhet publik në mënyrë që t'i mundësojë subjekteve të të dhënave që pa vështirësi të njoftohen me masat, më së voni kur të fillojë vëzhgimi me kamerë.

Në nenin 64 (paragrafi 4) të LMDHP thuhet se para instalimit të sistemit të vëzhgimit me kamerë, punëdhënësi duhet t'i informojë me shkrim subjektet e të dhënave për të drejtat e tyre dhe arsyet për vëzhgim. Hapësirat e mbikëqyrura duhet të shënohen nga punëdhënësit përmes shenjave të përshtatshme.

Siç është përshkruar në arsyetimin e këtij vendimi, bazuar në nenin 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbikëqyrësi kryesor shtetëror ka marrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Vendimi i dërgohet:

- Kuvendit të Republikës së Kosovës
- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Arkivit të Agjencisë

Ruzhdi Jashari

Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror



Adresa: Pejton Rr. Pashko Vasa Nr. 4, 10000 Prishtinë – Kosovë